**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"Aphrodite Aesthetics Clinic" sh.p.k.**

Sot, më datë 19.01.2022, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- **Znj. Afërdita Vorpsi**, shtetaseshqiptare, lindur më 15.04.1942, banuese në Tiranë, me numër personal E25415183F, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

**Neni 1**
**Themelimi**

1.1 Emri i shoqërisë është "**Aphrodite Aesthetics Clinic**" **Sh.p.k.**, këtu më poshtë e quajtur "**Shoqëria**". Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare tëBiznesit.

1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**
**Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Komuna e Parisit", Zona Kadastrale 8260, Ap F, Kati1, Objekti 1C-11, Tiranë.

2.2 Shoqëria mund të hape degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3**
**Objekti**

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

A. Trajtim estetik, trajtim lekure. bar kafe ;

B. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.;



AVorp

**Neni 4**

**Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njeqindmije) Lekë.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm :

- **Znj. Afërdita Vorpsi**, shtetaseshqiptare, lindur më 15.04.1942, banuese në Tiranë, me numër personal E25415183F, zotëruesee një kuote të Shoqërisë, me vlerë 100,000 (njeqindmije) Lekë, duke përfaqësuar 100% të kapitalit themeltar me të drejtë vote.

5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 6**

**Asambleja e Përgjithshme**

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

**Neni 7**

A Vorp

## Administratori

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Znj.Afërdita Vorpsi**, shtetaseshqiptare, lindur më 15.04.1942, banuese në Tiranë, me numër personal E25415183F, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pese) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori, i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

## Neni 8
## Viti Financiar

8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

8.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

## Neni 9
## Të ndryshme

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

**ORTAKU I VETEM**

**Afërdita Vorpsi**